



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË  
DHËNAVE PERSONALE  
DREJTORIA E PËRGJITHSHME PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT  
DREJTORIA E VLERËSIMIT TË ANKESAVE

Nr. 1272/4 Prot

Tiranë, më 12/8/2021

VENDIM

Nr. 39, datë 12.8.2021

PËR

URDHËRIMIN E AUTORITETIT PUBLIK

Në mbështetje të nenit 23 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, pikës 3 dhe 5 të nenit 24, të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, shkronjës a) të nenit 31/1 të ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale” i ndryshuar,

KONSTATOVA SE:

Ankuesja Organizata Sebastia, përfaqësuar nga znj. \_\_\_\_\_, ka depozituar pranë Zyrës së Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale (në vijim “Komisioneri”) Formularin e Ankesës nr. 1272 Prot., datë 26.07.2021, me objekt “Ankim ndaj refuzimit për dhënie informacioni dhe kopje të dokumenteve zyrtare”, kundër Autoritetit Publik “Ministria e Shendetësisë dhe Mbrojtjes Sociale” (në vijim “Autoriteti Publik”).

Ankuesja, në cilësinë e kërkueses, nëpërmjet shkresës datë 06.07.2021, ka kërkuar t’i vihet në dispozicion informacioni/dokumentacioni, në lidhje me:

1. Nëse ka data të reja lidhur me tejkalimin e afateve për rindërtimin e Spitalit Bashkiak Kurbini;
2. Projektin e plotë spitalit;
3. Emrin e firmës që ka fituar tenderin për rindërtimin e tij.

Në mungesë të një përgjigje nga ana Autoritetit Publik, me pretendimin se është cenuar në të drejtën për informim, ankuesi ka paraqitur ankim pranë Komisionerit, duke i kërkuar ushtrimin e kompetencave që i njeh ligji për rastet e refuzimit të dhënies së informacionit.

Zyra e Komisionerit pas shqyrtimit paraprak të ankesës, bazës ligjore dhe rrethanave të faktit të paraqitura në të, vlerësoi se ankesa përmbush kriteret formale ligjore, në

përputhje me përcaktimet e nenit 24 të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit” (në vijim “LDI”).

Në ndjekje të procedurës për shqyrtimin administrativ të çështjes, në përputhje me nenin 10 të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, i cili parashikon: “*Organi publik siguron që të gjitha palët dhe persona të tjerë të përfshirë në procedurë të jenë në gjendje të ndjekin dhe të mbrojnë të drejtat dhe interesat e tyre ligjorë në mënyrë sa më efektive dhe të lehtë të jetë e mundur*”, Komisioneri, me shkresën nr. 1272/1 prot., datë 27.07.2021 ka kërkuar nga Autoriteti Publik të informohet mbi trajtimin apo procedurën e ndjekur lidhur me kërkesën për informacion.

Autoriteti Publik, me shkresën nr. 2969/1 Prot., datë 26.07.2021, ka kthyer përgjigje duke informuar se: “*...Punimet për ndërtimin e ri të Spitalit të Laçit janë duke u realizuar konform zbatimit të projekt – preventivit në përputhje me të gjitha kushtet teknike dhe janë duke u monitoruar në mënyrë të vazhdueshme nga strukturat përkatëse. Ndërtesa e re e spitalit është duke u ndërtuar mbi gjurmën e ndërtesës së spitalit të vjetër dhe aktualisht punimet janë në fazën e kryerjes së volumeve kryesore të punimeve të ndërtimit dhe atyre të montimit të strukturës metalike të korpusit qendror të spitalit dhe të ndërtesës teknike ku do të instalohen impiantet elektro – mekanike.*

*Të gjitha shërbimet spitalore, që ofroheshin nga Spitali i Laçit nuk janë ndërprerë për asnjë moment dhe vijojnë të ofrohen konform të gjitha kushteve në ambientet alternative të siguruara nga Drejtoria e Spitalit Bashkiak të Laçit. Vonesat gjatë ekzekutimit të punimeve kanë ardhur si pasojë e faktorëve dhe kushteve teknike të paparashikuar, regullimi i të cilave është i përcaktuar edhe në legjislacionin në fuqi por edhe në kushtet e kontratës. Kompania e cila po zbaton punimet në Spitalin e Laçit është “Consortio Nazionale Cooperative di produzione e Lavoro “Ciro Menotti” Societa Cooperativa per Azioni”, akronimi i së cilës është “Ciro Menotti””.*

Ankuesja, duke e konsideruar të paplotë përgjigjen e dhënë nga Autoriteti Publik, ka vijuar me ankimin e regjistruar pranë Zyrës së Komisionerit me nr. 1272/2 Prot., datë 30.07.2021, duke kërkuar saktësisht projektin e plotë të spitalit.

Zyra e Komisionerit, nëpërmjet e-mail-it datë 02.08.2021, kërkoi nga Autoriteti Publik qëndrimin përfundimtar lidhur me këtë çështje, por nga Autoriteti Publik nuk pati reagim në përgjigje të kësaj kërkesë.

Pas konsultimit të legjislacionit përkatës dhe dokumentacionit bashkëlidhur ankesës, Komisioneri vlerëson se, informacioni i kërkuar lidhet me një projekt publik për ndërtimin e një objekti shëndetësor në varësi të Autoritetit Publik, për të cilën ky i fundit disponon informacion.

Gjithashtu, konstatohet se Autoriteti Publik, nuk ka provuar se është përpara kufizimeve të përcaktuara në nenin 17 të LDI, për mosvënien në dispozicion të dokumentacionit të kërkuar.

Në këto kushte, dokumentacioni lidhur me projektin e plotë të spitalit (objekt i kërkesës datë 06.07.2021) në parim përbën informacion publik në kuptim të pikës 2 të nenit 2 të LDI, në të cilën parashikohet se, *“informacion publik” konsiderohet çdo e dhënë e regjistruar në çfarëdo lloj forme dhe formati, gjatë ushtrimit të funksionit publik pavarësisht nëse është përpiluar ose jo nga Autoriteti Publik”*.

Për sa më sipër, Autoriteti Publik duhet të vendosë në dispozicion të kërkuarit çdo informacion/dokument i cili është prodhuar ose mbahet nga ky i fundit në formën e zotëruar, në përputhje me pikën 6 të nenit 17 të LDI.

Bazuar në pikën 3 të nenit 3 të LDI, *“Çdo person ka të drejtë të njihet me informacionin publik, nëpërmjet dokumentit original ose duke marrë një kopje të tij në formën ose formatin që mundëson akses të plotë në përmbajtjen e dokumentacionit”*.

E drejta për informim është një prej të drejtave themelore të njeriut, e parashikuar në nenin 23 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë. Kjo e drejtë duhet parë e lidhur ngushtë me parimin e transparencës dhe llogaridhënies, si një shtyllë tjetër themelore e shtetit të së drejtës. Funksionimi i tyre do të ishte në interesin e të dy palëve.

## PËR KËTO ARSYE

Bazuar në shkronjat b) dhe ç) të pikës 5 të nenit 24, nenit 25 të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, shkronjën a) të pikës 1 të nenit 18 të ligjit nr. 49/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative” i ndryshuar,

## V E N D O S A:

1. Pranimin e ankesës nr. 1272 Prot., datë 26.07.2021 të Organizatës Sebastia, përfaqësuar nga znj. \_\_\_\_\_, kundër Autoritetit Publik “Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale”, me objekt *“Ankim ndaj refuzimit për dhënie informacioni dhe kopje të dokumenteve zyrtare”*.
2. Urdhërimin e Autoritetit Publik, për vënien në dispozicion të dokumentacionit sipas kërkesës për informacion datë 06.07.2021, duke respektuar kufizimet, në përputhje me pikën 6 të nenit 17 të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, konkretisht: Projektin e plotë të spitalit, brenda datës 19 . 8 . 2021.
3. Kundër këtij vendimi palët kanë të drejtën e ankimit në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijeni, sipas nenit 25 të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”.
4. Ky vendim u shpall sot në datë 12 . 8 . 2021.

KOMISIONERI

Besnik Dervishi

